

Relacion shoqërues

I. Organizimi i punës për hartimin e PBA-së 2019-2021

1. Me paraqitjen e tavanëve buxhetor është bërë edhe ristrukturimi i programeve buxhetore sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.6/1 datë 28.02.2018 ‘Për Përgatitjen e Buxhetit Vendor’, ku nga 29 programe të standartizuara për njësitë publike për njësitë tona u miratuan 15 programe të pershtatura me natyrën, funksionin dhe aktivitetet e njësisë tonë. Janë bërë ndryshimet përkatëse në ekipet e menaxhimit dhe në grupin e menaxhimit strategjik miratuar me urdhezimin nr.1 e Titullarit, nr.874 prot date 19.04.2018 ‘Për përgatitjen e Buxhetit Afatmesëm 2019-2021.. Është hartuar kalendari i brendshëm për përgatitjen e kërkesave buxhetore miratuar me vendim këshilli nr.3 datë 15.02.2018 dhe konfirmim nga prefekti i Qarkut Fier nr.265/1 datë 28.02.2018..

2. Grupi i menaxhimit Strategjik me miratimin e tavanëve buxhetore 2019-2021 me vendimin e këshillit bashkiak nr.14 datë 20.03.2018 dhe konfirmuar nga prefekti i Qarkut Fier nr.2410/1 datë 5.4.2018. Ekipet e menaxhimit me shkresën nr.874/1 datë 19.04.2018 kanë marrë tavanët buxhetor 2019-2021 për hartimin e kërkesave buxhetore dhe kërkesave shtese të cilat janë paraqitur pranë GMS për miratim brenda afatëve të përcaktuara.

3. Nepunësi Autorizues i njësisë Kryetare e Bashkisë me shkresë nr.1248 prot, datë 01.06.2018 ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë Projektdokumentin e Programit Afatmesëm 2019-2021. Me dërgimin e rekomandimeve të Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, materiali i kalon Këshillit Bashkiak për miratim.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të radhës miraton Projekt vendimin për PBA-2019-2021.

I.1 Situatë njësisë tone (veshtrim i përgjithshëm).

Bashkia Patos është pjesë e Qarkut Fier dhe ka një sipërfaqe prej 82.5 km², me qendër qytetin e Patosit. Ajo kufizohet në veri dhe në lindje nga bashkia e Roskovecit, në jug me bashkinë e Mallakastrës dhe në perëndim me bashkinë e Fierit. Kjo bashki përbëhet nga dy njësi administrative, të cilat janë: Zharrëza dhe Ruzhdia. Bashkia e Patosit, në bazë të statistikave të vitit 2011 sipas Censurit regjistron 22.959 banorë dhe densitet prej 278.3 b/km², ndërsa sipas Regjistrit të Gjendjes Civile në vitin 2017 rezultoi 42.889 banorë.

Aktualisht bashkia Patos nuk disponon Plan të Përgjithshëm Vendor, planet e fundit datojnë në vitet '70 dhe janë të shfuqizuar.

Mungesa e planifikimit të mirëfilltë në territorin e Njësisë të Qeverisjes Vendore, ka bërë që komunitetet të cilat pësuajnë rritje si demografike ashtu edhe ekonomike, të ndërtonin struktura dhe shtëpi të reja, pa lejet përkatëse të parashikuara nga ligji, duke zënë tokat bujqësore dhe duke ndryshuar destinacionin e këtyre të fundit.

E gjithë kjo situatë ka rezultuar në: a) ekspansion të ndërtimeve informale; b) mungesë të infrastrukturës; c) mungesë të “qendrave” të fshatrave, ku të zhvillohen aktivitete sociale, kulturore e tregtare; d) mungesë të ardhurash nga taksa e ndërtimit për Njësitë e Qeverisjes Vendore; e) mungesë të fondeve të këtyre të fundit për të investuar në infrastrukturë e më gjerë; f) kthim në

shkallë të gjerë i tokës bujqësore në tokë urbane; g) diferencim i lartë në përdorimin e tokës, ku zonat e banimit janë larg zonave tregëtare e qendrave të aktiviteteve; h) ndërtime përgjatë akseve rrugore; i) varësi ndaj lëvizjes me automjete; j) pak ose aspak mundësi për transport publik; k) shtim i impakteve mjedisore.

Në 17.05.2018 është ndërmarrë vendimi nga kryetari i bashkisë Patos për nismën e planit të përgjithshëm vendor për gjithë territorin e bashkisë.

Plani i Përgjithshëm Vendor, përmes planifikimit të kujdesshëm dhe zbatimit të instrumenteve përkatëse, do të tentojë të zgjidhë problemet ekzistuese që lidhen me çështjet e ndotjes së mjedisit, ajrit, ujërave nëntokësorë, zhvillimit informal etj. Plani i zhvillimit adreson në mënyrë të vecantë dhe çështje të cilat lidhen me situatën social ekonomike, ku nëpërmjet politikave të zhvillimit synohet nxitja e ekonomisë lokale dhe rajonale, ulja e nivelit të papunësisë dhe rritja e mirëqënies sociale dhe ekonomike.

Krahas problematikave të mësipërme, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Patos do të vendosi theks në zgjidhjen e problematikave të lidhura me zhvillimin e territorit si informaliteti, humbja e tokave bujqësore, mungesa e infrastrukturave publike etj.

1.1 Çështjekryesore për projektet dhe politikat e bashkisë

Duke pasur parasysh situatën e qeverisjes vendore është përgatitur një listë të investimeve që kanë më shumë prioritet dhe janë më shumë të nevojshme për rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe rritjen urbane të qytetit. Këto projekte do të japin zgjidhje të integruar të projekteve të largimit të ujërave të ndotura, kanalizimeve dhe rehabilitimit/ndërtimit të akseve të infrastrukturës.

1. Ngritja e një Sistemi të Grumbullimit të Mbetjeve
2. Përmirësimi i Rrjetit të Furnizimit me Ujë në zone
3. Ujitja dhe Konsolidimi i Tokës
4. Organizimi i Vendit të Tregtimit të Produkteve Bujqësore
5. Rehabilitimi i infrastrukturës në tërësi
6. Rehabilitimi i Vendgrumbullimit të Mbetjeve
7. Rrjeti i Hapësirave të Hapura
8. Rrjeti i Përdorueseve të Bicikletave dhe Shëtitor

1.3 Informacion financiar Kryesor

Burimi i informacionit: Nxjerrë nga Instrumentii Planifikimit Financiar

2.Orientimi afatgjatë i bashkisë

2.1 Strategjia e zhvillimit afatgjatë/strategjia territorial

Strategjia e zhvillimit territorial synon të:

- a) Drejtojë zhvillimin territorial bazuar në planifikimin e hapësirave të reja; përfshirëse dhe të integruara, që do të garantojë menaxhimin dhe kontrollin e territorit duke siguruar zhvillim urban të qëndrueshëm, zhvillim industrial dhe turizmin;
- b) Koordinojë vizionin lokal dhe zhvillimin e objektivave të planifikimit urban me vizionin dhe objektivat e përcaktuara në dokumentin kombëtar të zhvillimit të planifikimit urban;
- c) Vlerësojë potencialet ekzistuese dhe perspektivat territoriale;

- d) Promovojë përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës lokale sipas standardeve të BE, veçanërisht infrastrukturën e transportit për të mbështetur krijimin e një zone me aktivitet të përbashkët ekonomik në nivel lokal dhe më sipër;
- e) Promovojë mbrojtjen e mjedisit nga ndotja dhe degradimi, gjithashtu të promovojë rehabilitimin e zonave të ndotura në të gjitha zonat problematike të identifikuar, në përputhje me standardet e BE;
- f) Promovojë dhe mbështesë zhvillim social të shpejtë, të balancuar dhe të qëndrueshëm brenda territorit vendor.

2.2 Sfidat kryesore të zhvillimit

Urbanizimi i shpejtë në Shqipëri, pas viteve 90', ka krijuar hapsira të karakterit informal në cdo zonë. Ndërtimi pa kriter ka sjelle fragmentarizim, reduktim dhe përzjerje funksionesh në tokat bujqësore. Mungesa e instrumentave të planifikimit ka bërë të mundur kthimin e një pjese të madhe të tokave bujqësore në toka urbane. Gjithashtu edhe në zonën urbane vërehet një numër i madh i objekteve informale të cilat shpeshherë janë prishur për arsye të interesit publik. Kjo shoqërohet edhe me kosto shtesë për bashkinë në zhvillimin e territorit.

Sfida kryesore të zhvillimit që çojnë në nevojën e menjëhershme për hartimin e këtij plani janë

- a) Krijimi i kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm në gjithë territorin e bashkisë
- b) Balancim i nevojave dhe interesave kombëtarë e vendorë për zhvillimin e territorit
- c) Mospasja e një dokumenti planifikimi në fuqi
- d) Nivel i ulët i investimeve të huaja
- e) Zhvillim i paorientuar që nuk sjell asnjë avantazh konkurrues
- f) Nivel i ulët i industrisë përpunuese
- g) Sipërfaqe toke të lëna djerrë
- h) Mungon transporti publik ndërqytetas
- i) Vendbanimet dhe popullsia janë të shpërndara dhe bëjnë të vështirë ofrimin e shërbimeve
- j) Mirëmbajtje e dobët e rrjetit rrugor dhe hapësirave të gjelbra
- k) Rrjeti aktual i kanalizimeve është i pamjaftueshëm dhe nuk ka një impiant trajtimi të ujrave të zeza;
- l) Mungese aktiviteti në masat e mbrojtjes së mjedisit (menaxhimi i mbetjeve, ujërave të përdorura);
- m) Pamjaftueshmëri në furnizimin me ujë të pijshëm me pasoja për biznesin, turizmin dhe bujqësinë;
- n) Zhvillimi kaotik dhe përdorimi jo racional i tokës dhe burimeve natyrore;
- o) Shumë zona me ndërtime në territorin e bashkisë nuk kanë infrastrukturë rrugore të duhur dhe shërbime të tjera publike (lagjet e reja);

- p) Probleme të vazhdueshme me ujitjen dhe kullimin për një pjesë të madhe të tokave në fushë;

3. Projektet kryesore të PBA-së 2019-2021

3.1 Paraqitja e projekteve kryesore–arsyet dhe përfituesit

Burimi i informacionit: Degjesat vjetore dhe mujore me publikun si dhe PBA vjetore. Si burim informacioni Projekt Buxheti Afatmesem.

Programi 1: Fonde që shkojnë në financimin e rikonstruksionit të godinave të Bashkise por edhe të Ndermarrjeve vartese. Nderhyrja do të jetë e plotë dhe në riorganizimin e hapsirave.

Programi 4. Këto fonde parashikohet të investohen në objektet publike institucione , për marrjen e masave të mbrojtjes nga zjarri , në kuadër të pershtatjes së ambienteve publike sipas normativave që duhet të përmbushin për sistemin e mbrojtjes nga zjarri. Parashikohen ndërhyrje në Godinat arsimore , institucionet publike , administrata, godinat e NJ.Q.V. etj.

Programi 5: Në Programin e sigurisë , parashikohet të ndërhyet në ndertimin e sinjalistikës së nevojshme , kryesisht në infrastrukturën rrugore por edhe në nyjet që konsiderohen të rrezikshme.

Programi 6: Parashikohet të ndërtohet tregu bujqësor I qytetit. Jemi në fazën ku është bërë hartimi I projektit të zbatimit ndërsa investimi pritet të shtrihet në 2 vite.

Programi 7: Parashikohet të bëhen investime në pyllëzimin e zonës së sheqishtës

Programi 8: Parashikohet të bëhen investime në fushën e infrastrukturës rrugore , rrugë , trotuares , rrugica etj. Këto investime shtrihen në gjithë territorin e bashkisë Patos.

Programi 10: Programi I menaxhimit të mbetjeve konsiston në kryerjen e investimeve të nevojshme në mirëmbajtimin e mbetjeve urbane, krijimin e infrastrukturës së nevojshme por edhe në blerjen e mjeteve të posaçme për trajtimin e këtyre mbetjeve.

Programi 11: Programi I menaxhimit të ujërave të zeza konsiston në krijimin e një rrjeti të ri të kanalizimeve në zonat informale si dhe krijimi I një rrjeti bashkëkohor për zonat ku vetët paraqiten gjendje emergjente.

Programi 13: Mbrojtja mjedisore, do të ketë fokusimin kryesor në mobilizimin ndër vite për sensibilizimin e qytetarëve për mbrojtjen mjedisore, bashkëpunimin me institucionet përkatëse për kontrollin e territorit ndaj ndotësve si dhe implementimin e teknikave të reja të trajtimit të mjedisit.

Programi 14: Programi I strehimit ka si qëllim primar krijimin e ambienteve për strehimin e familjeve në nevojë dhe për këtë parashikon në rehabilitimin e ambienteve ekzisuese, prona të bashkisë, në krijimin e kushteve të pershtatshme për strehimin e tyre.

Programi 15: Investimet ne kete program konsistojne ne krijimin e ambienteve te pershtatshme per aktivite kulturore si dhe mbeshtetjen e ideve inovatore. Per kete parashikohet te ndertohen qendra multifunksionale.

Programi 16: Furnizimi me uje konsiston ne ndertimin e rrjetit te ri te ujesjellesit si dhe zvendesimet e rrjeteve ekzisutese te demtuara apo ndertimin e infrastrukturave te nevojsheme.

Programi 17: Konsiston ne vendosjen e ndricimit rrugor neper rruget aktualisht te pa pajisura me ndricim rrugor si dhe zvendesimin e nevojshem te ndricimit ezistues me ndricuesa LED , per kursimin e energjise.

Programi 19: Ne kete program parashikohet te invesohen ne rivitalizime te terreneve te zapotuar apo ndertimin e lulishteve ne ambientet e bashkise.

Programi 21: Arsimi Baze dhe parashkollore merr cdo vit investime te riparimit dhe te mirembajtjes , per plotesimin e kushteve te nevojshme .

Programi 22: Arsimi I mesem merr cdo vit investime te riparimit dhe te mirembajtjes , per plotesimin e kushteve te nevojshme .

Programi 25: Programi per te moshuarit , do te konsistojne ne krijimin e ambienteve te nevojshme per te qendruar apo pushuar moshat e treta, krijimin e infrastruktures se nevojshme per plotesimin e kushteve baze.

Nepunesi Autorizues

Rajmonda BALILAJ

BASHKIA PATOS

**Lenda: Relacion mbi ecurine e Buxhetit Afatmesem 2019-2021,dhe informimi
mbi tavanet perfundimtar te ketij buxheti.**

Keshillit te Bashkise.

I. Organizimi i punës për hartimin e PBA-së 2019-2021

- Grupi i menaxhimit Strategjik me miratimin e tavaneve buxhetore 2019-2021 me vendimin e keshillit bashkiak nr.14 datë 20.03.2018dhe konfirmuar nga prefekti i Qarkut Fier nr.2410/1 datë 5.4.2018.Ekipet e menaxhimit me shkresën nr.874/1 datë 19.04.2018 kane marrë tavanët buxhetor 2019-2021 për hartimin e kerkesave buxhetore dhe kerkesave shtese te cilat jane paraqitur prane GMS për miratim brenda afateve te percaktuara.
- Nepunesi Autorizues i njesise Kryetare e Bashkisë me shkrese nr.1248 prot,datë 01.06.2018 ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë Projekt-dokumentin e Programit Afatmesëm 2019-2021 .Me dergimin e rekomandimeve të Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,materiali i kalon Këshillit Bashkiak për miratim. Me vendim nr.36 date 19.06.2018 keshilli i bashkise miratoi projektin e pare te programit buxhetor afatmesem 2019-2021.
- Sipas kalendarit te miratuar nga keshilli bashkiak si dhe ne zbatim te udhezimit Plotesues te MF nr.6/3 date 10.07.2018 brenda dt 20.7.2018 ekzekutivi duhet te paraqese per miratim tavanet perfundimtare te project buxhetit afatmesem 2019-2021. Nisur nga fakti se gjate periudhes se pergatitjes se PBA 2019-2021 faza e pare, dhe mbas miratimit te projektit te pare te PBA 2019-2021 nuk ka pasur ndryshime si ne planin e te ardhurave dhe ne planin e shpenzimeve,GMS ju informon se tavanet pergatitore te fazes se pare do te jene edhe tavane perfundimtar .
- Do te vazhdoje puna per identifikimin e kerkesave te reja per pergatitjen e PBA se rishikuar brenda muajit shtator 2018.

Grupi i Menaxhimit Strategjik:

- | | | | |
|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|
| 1. Vilma Zhupaj | 6. Shkëlqim Beqiraj | 11. Artjol Hoxha | 16. Agim Mesutaj |
| 2. Mimoza Shtëmbari | 7. Vangjel Nushi | 12. Novruz Toska | 17. Alba Gollosi |
| 3. Afërdita Laska | 8. Andon Kristo | 13. Luto Yzeiraj | 18. Ilva Toska |
| 4. Agim Muskaj | 9. Anisa Petani | 14. Blerina Troka | 19. Lindita Qalliaj |
| 5. Hiqmet Cela | 10. Daniel Xeba | 15. Arben Semanjaku | 20. Arben Shpërdh |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

Miratoi:
KRYETARE
Rajmonda **BALILAJ**

Lenda: Relacion mbi ecurine e Buxhetit Afatmesem 2019-2021,dhe informimi
mbi tavanet perfundimtar te ketij buxheti

Keshillit te Bashkise.

I. Organizimi i punës për hartimin e PBA-së 2019-2021

- Grupi i menaxhimit Strategjik me miratimin e tavanëve buxhetore 2019-2021 me vendimin e keshillit bashkiak nr.14 datë 20.03.2018dhe konfirmuar nga prefekti i Qarkut Fier nr.2410/1 datë 5.4.2018.Ekipet e menaxhimit me shkresën nr.874/1 datë 19.04.2018 kane marrë tavanët buxhetor 2019-2021 per hartimin e kerkesave buxhetore dhe kerkesave shtese te cilat jane paraqitur prane GMS per miratim brenda afateve te percaktuara.
- Nepunesi Autorizues i njesise Kryetare e Bashkisë me shkrese nr.1248 prot,datë 01.06.2018 ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë Projekt-dokumentin e Programit Afatmesëm 2019-2021 .Me dergimin e rekomandimeve të Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,materiali i kalon Këshillit Bashkiak për miratim. Me vendim nr.36 date 19.06.2018 keshilli i bashkise miratoi projektin e pare te programit buxhetor afatmesem 2019-2021.
- Sipas kalendarit te miratuar nga keshilli bashkiak si dhe ne zbatim te udhezimit Plotesues te MF nr.6/3 date 10.07.2018 brenda dt 20.7.2018 ekzekutivi duhet te paraqese per miratim tavanet perfundimtare te project buxhetit afatmesem 2019-2021. Nisur nga fakti se gjate periudhes se pergatitjes se PBA 2019-2021 faza e pare, dhe mbas miratimit te projektit te pare te PBA 2019-2021 nuk ka pasur ndryshime si ne planin e te ardhurave dhe ne planin e shpenzimeve,GMS ju informon se tavanet pergatitore te fazes se pare do te jene edhe tavane perfundimtar .
- Do te vazhdoje puna per identifikimin e kerkesave te reja per pergatitjen e PBA se rishikuar brenda muajit shtator 2018.

Grupi i Menaxhimit Strategjik:

6. Vilma Zhupaj	6. Shkëlqim Beqiraj	11. Artjol Hoxha	16. Agim Mesutaj
7. Mimoza Shtëmbari	7. Vangjel Nushi	12. Novruz Toska	17. Alba Golloshi
8. Afërdita Laska	8. Andon Kristo	13. Luto Yzeiraj	18. Ilva Toska
9. Agim Muskaj	9. Anisa Petani	14. Blerina Troka	19. Lindita Qalliaj
10. Hiqmet Cela	10. Daniel Xeba	15. Arben Semanjaku	20. Arben Shpërdheja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

Miratoi:
KRYETARE
Rajmonda **BALILAJ**

Lenda: Relacion mbi Rishikimin e e Buxhetit Afatmesem 2019-2021.

Keshillit te Bashkise.

I. Organizimi i punës për hartimin e PBA-së 2019-2021

- Grupi i menaxhimit Strategjik me miratimin e tavanëve buxhetore 2019-2021 me vendimin e keshillit bashkiak nr.14 datë 20.03.2018 dhe konfirmuar nga prefekti i Qarkut Fier nr.2410/1 datë 5.4.2018. Ekipet e menaxhimit me shkresën nr.874/1 datë 19.04.2018 kanë marrë tavanët buxhetor 2019-2021 për hartimin e kërkesave buxhetore dhe kërkesave shtese të cilat janë paraqitur pranë GMS për miratim brenda afateve të percaktuara.
- Nepunësi Autorizues i njesise Kryetare e Bashkisë me shkresë nr.1248 prot, datë 01.06.2018 ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë Projekt-dokumentin e Programit Afatmesëm 2019-2021. Me dërgimin e rekomandimeve të Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, materiali i kalon Këshillit Bashkiak për miratim. Me vendim nr.36 datë 19.06.2018 keshilli i bashkisë miratoi projektin e parë të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021.
- Sipas kalendarit të miratuar nga keshilli bashkiak si dhe në zbatim të udhëzimit Plotësues të MF nr.6/3 datë 10.07.2018 brenda dt 20.7.2018 ekzekutivi duhet të paraqesë për miratim tavanet përfundimtare të projekt buxhetit afatmesëm 2019-2021. Nisur nga fakti se gjatë periudhës së përgatitjes së PBA 2019-2021 faza e parë, dhe mbas miratimit të projektit të parë të PBA 2019-2021 nuk ka pasur ndryshime si në planin e të ardhurave dhe në planin e shpenzimeve, GMS ju informon se tavanet përgatitore të fazës së parë do të jenë edhe tavanet përfundimtar.
- Do të vazhdojë puna për identifikimin e kërkesave të reja për përgatitjen e PBA së rishikuar brenda muajit shtator 2018.

Grupi i Menaxhimit Strategjik:

11. Vilma Zhupaj	6. Shkëlqim Beqiraj	11. Artjol Hoxha	16. Agim Mesutaj
12. Mimoza Shtëmbari	7. Vangjel Nushi	12. Novruz Toska	17. Alba Gollosi
13. Afërdita Laska	8. Andon Kristo	13. Luto Yzeiraj	18. Ilva Toska
14. Agim Muskaj	9. Anisa Petani	14. Blerina Troka	19. Lindita Qalliaj
15. Hiqmet Cela	10. Daniel Xeba	15. Arben Semanjaku	20. Arben Shpërdheja

